



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 823/g Prot.

Tiranë, më 21.04 2026

V E N D I M

Nr. 64 dt. 21.04 2026

“PËR MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURAVE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT “BACHELOR” NË “AKTIVITETE NË NATYRË (OUTDOOR) DHE TURIZËM SPORTIV”, ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETIT TË VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT DHE UNIVERSITETIT POLITEKNIK SANTAREM, PORTUGALI DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT”

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, shkresën nr. 824/1 prot., datë 20.04.2026 të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit “Përcjellje e propozimit për hapjen e programit të dyfishtë “Bachelor” në “Aktivitete në natyrë (outdoor) dhe turizëm sportiv”, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Santarem Polytechnic University Portugali”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.04.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nisjes së procedurave për hapjen e programit të përbashkët “Bachelor” në “Aktivitete në natyrë (outdoor) dhe turizëm sportiv”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Universitetit Politeknik Santarem, Portugali.
2. Miratimin e Marrëveshjes së programit të përbashkët “Bachelor” në “Aktivitete në natyrë (outdoor) dhe turizëm sportiv”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Universitetit Politeknik Santarem, Portugali.

3. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit të UST-së, Bordit të Administrimit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASO

